Me kallashnikov pa leje kryenin qitje gjatë natës dhe postonin videot në TikTok, 6 të arrestuar në Durrës

25 Mars, 2024 12:08

Madhësia e tekstit:

Policia e Durrësit ka arrestuar 6 persona pasi akuzohen se me një kallashnikov pa leje, kryenin gjatë natës qitje dhe postonin videot në TikTok.

Burime zyrtare nga policia bëne me dije se pas hekurave ranë shtetasit me inicialet Nj. S., 56 vjeç dhe M. S., 19 vjeç, babë e bir, të dy banues në fshatin Rrushkull, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe shtetasit me inicialet K. P., 19 vjeç, K. J., 20 vjeç, A. T., 18 vjeç, A. H., 19 vjeç dhe E. T., 19 vjeç, të gjithë banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

NJOFTIMI I POLICISE

Mbanin armë zjarri (kallashnikov) pa leje dhe kryenin qitje gjatë natës, me qëllim postimin e videove në TikTok, vihen në pranga 6 shtetas dhe procedohet penalisht 1 i mitur. Në pranga dhe babai i njërit prej të arrestuarve, pasi në banesë iu gjet një tjetër armë zjarri (pushkë).

Sekuestrohen 2 armët e zjarrit, 2 krehra, rreth 500 fishekë luftarak, 8 celularë dhe 2 automjete. Në kuadër të zbatimit të planit të masave të përcaktuara në planin operacional kombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", bazuar në inteligencën policore, si dhe pas monitorimit të vazhdueshëm të rrjeteve sociale, ku disa të rinj postonin video në të cilat shfaqeshin duke kryer qitje me armë zjarri, gjatë natës, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Durrës, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Qitësit".

Gjatë operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

•Nj. S., 56 vjeç dhe M. S., 19 vjeç, babë e bir, të dy banues në fshatin Rrushkull, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit ";

Sponsored Links

•K. P., 19 vjeç, K. J., 20 vjeç, A. T., 18 vjeç, A. H., 19 vjeç dhe E. T., 19 vjeç, të gjithë banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Gjithashtu, në vijim të operacionit, u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për një 17-vjeçar, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". 7 të rinjtë e arrestuar/proceduar u kapën në flagrancë pas sigurimit të informacionit, se ata po përgatiteshin për të qëlluar në kodrën e fshatit Hamallaj, me armë zjarri që i posedonin pa leje, me qëllim postimin e videove në rrjetin social "TikTok".

Gjatë operacionit u gjet arma e zjarrit kallashnikov me të cilën të rinjtë kryenin qitje. Në vijim, gjatë kontrollit në banesën e shtetasve Nj. S. dhe M. S., ku u kap 56-vjeçari, Policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri pushkë dhe municion luftarak. Së bashku me armët, u sekuestruan 2 automjetet me të cilat lëvizinin këta shtetas, si dhe 8 celularë. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arrestim | Durres

Ad

TË NGJASHME

Goditi me grushte dhe shkelma një të mitur, arrestohet 72-vjeçari në Elbasan
25 Mars, 2024

Sekuestrohet një kallashnikov, municion luftarak dhe një tshkë, arrestohen babë e bir në Tiranë
24 Mars, 2024

Taboola Feed

"Nuk kam parë kurrë në jetë", qengji i porsalindur trondit fermerin
balkanweb.com

Shiti shtëpinë pas humbjes së nënës, Ardit Gjebrea rrëfen dhimbjen: Ktheja kokën dhe ajo nuk ishte aty
balkanweb.com

Sylvinho ndryshon Shqipërinë, trajneri "përzien kartat", edhe në Suedi "ligjin" e bëjnë tifozët kuqezi
balkanweb.com

Detaje/ Si do të organizohen kampet në Shëngjin dhe Gjadër, ja si do të bëhet shpërndarja e refugjatëve. Nëse dalin...
balkanweb.com

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

U arrestua për shpërdorim detyre, jepet nesër masa e sigurisë për krysbashkëkëshin Jorgo Goro
25 Mars, 2024

Erjon Bani zgjidhet zëvendëskryetar i GLJKKO-së, zëvendësoni Irena Gjokën
25 Mars, 2024

Plagosja në Pogradec, sherri mes vëllezërve për motivet të dobëta, në momentin e ngjarjes autori...
25 Mars, 2024

Përfshihet nga flakët banesa në Milot, shpëton mekullisht çifti i të moshuarve
Enver Doçi | 25 Mars, 2024

SPAK çon për gjykim ish-gjyqtarin Ilir Pashaj: Si përfitoi pasuri të paligjshme përmes korrupsionit
25 Mars, 2024

Autori me skafandër zbret nga motori dhe heth eksplozivin, detaje nga shpërthimi në Shkodër. Dëshmia e prokurës së banesës: S'kam konflikte!
Senad Nikshiqi | 25 Mars, 2024

KATEGORIA VIDEO

Rizoto kremoz që shkrin në gojë
25 Mars, 2024

"Komisionet, njollë e zezë e parlamentarizmit", Petro Koçi nga komisioni hetimor për shëndetësinë: Janë thirur skifteri, të mos kemi histori kacafytjesh
25 Mars, 2024

Kek me mueslі pa gluten
25 Mars, 2024

"Marrëm kusi dhe kazanë", Korreshi ironizon te Komisioni Hetimor për shëndetësinë: Shpalësi aksionin opozitar se na mallëngjyet
25 Mars, 2024

Debate në komisionin për koncesionin e sterilizimit dhe Check-Up/ Deputeti i PS kapet me Vokshin: Jo deklarata partiake, të respektohet kushtetuta! Demokratja: Dy skandale të mëdha!
25 Mars, 2024

Berisha kërkon të lejohet të marrë pjesë në Parlament, GLJKKO tërhiqet për të marrë vendimin, avokati Çjokutaj: SPAK kërkon ta trajtojë si të burgosur
25 Mars, 2024

BalkanWeb App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Rizoto kremoz që shkrin në gojë
25 Mars, 2024

"Komisionet, njollë e zezë e parlamentarizmit", Petro Koçi nga komisioni hetimor për shëndetësinë: Janë thirur skifteri, të mos kemi histori kacafytjesh
25 Mars, 2024

Kek me mueslі pa gluten
25 Mars, 2024

"Marrëm kusi dhe kazanë", Korreshi ironizon te Komisioni Hetimor për shëndetësinë: Shpalësi aksionin opozitar se na mallëngjyet
25 Mars, 2024

Debate në komisionin për koncesionin e sterilizimit dhe Check-Up/ Deputeti i PS kapet me Vokshin: Jo deklarata partiake, të respektohet kushtetuta! Demokratja: Dy skandale të mëdha!
25 Mars, 2024

Berisha kërkon të lejohet të marrë pjesë në Parlament, GLJKKO tërhiqet për të marrë vendimin, avokati Çjokutaj: SPAK kërkon ta trajtojë si të burgosur
25 Mars, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.